

20080891672

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E**  
**LIGJIT PËR VEPRIMTARI HOTELIERE**

Neni 1

Në Ligjin për veprimtari hoteliere (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 62/2004), pas nenit 5 shtohet nen i ri 5-a si vijon:

“Neni 5-a

Personat fizikë dhe juridikë nga fusha e hotelerisë me qëllim të përparimit të veprimtarisë mund të bashkohen në forma të ndryshme të bashkimit në pajtim me ligjin.”

Neni 2

Neni 7 ndryshon si vijon:

“Hotelieri është i detyruar që përmbushjen e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji dhe fillimin me punë t’ia paraqesë Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit kryetarit të Komunës në rajonin e Qytetit të Shkupit në bazë të vendit dhe selisë të objektit, gjegjësisht në bazë të vendit ku jepen shërbimet, më së paku 15 ditë para fillimit me punë të objektit hotelier.

Hotelieri është i detyruar t’ia paraqesë edhe ndryshimin e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, kryetarit të Komunës në rajonin e qytetit të Shkupit në bazë të vendit dhe selisë të objektit, gjegjësisht në bazë të vendit ku jepen shërbimet, në afat prej 15 ditëve nga ndryshimet e bëra.

Ministri i Ekonomisë e rregullon formën dhe përmbajtjen e formularit të fletëparaqitjes nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.”

Neni 3

Në nenin 8, paragrafi 1 fshihet.

Paragrafi 2 bëhet paragraf 1.

Në paragrafin 3 i cili bëhet paragraf 2 fjalët në fund të fjalisë: “paragrafi 2 i këtij neni” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi 1 i këtij neni.”

Neni 4

Në nenin 10 fjalët: “paragrafi 2” zëvendësohen me fjalët: “paragrafi 1”.

Neni 5

Në nenin 12, në paragrafin 3 fjalët: “(tarraca dhe kopshte verore)” fshihen.

Neni 6

Nenet 13 dhe 14 fshihen.

Neni 7

Në nenin 15 pas fjalës “pije” presja zëvendësohet me pikë dhe fjalët deri në fund të fjalisë fshihen.

Neni 8

Në nenin 22, paragrafi 1 ndryshon si vijon:

“Licenca nga neni 20 lëshohet në afat prej tetë ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës nga ana e kryerësit të veprimtarisë hoteliere dhe vlen për periudhë njëvjeçare.”

Pas paragrafit 1 shtohet paragrafi i ri 2, si vijon:

“Nëse organi kompetent nuk jep licence në afat nga paragrafi 1 të këtij neni, do të llogaritet se është përgjegjur pozitivisht sipas kërkesës.”

Paragrafi 2 bëhet paragrafi 3.

#### Neni 9

Në nenin 23 shtohet paragraf i ri 2 si vijon:

“Me përjashtim të dispozitave nga paragrafi 1 pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, objektet hoteliere për ushqim të shpejtë (dyqan sandviçësh) mund të punojnë deri në orën 01.00 në periudhën e dimrit, gjegjësisht deri në orën 02.00 në periudhën e verës, ndërsa në ditët e premte dhe e shtunë, në prag të ditëve të festave dhe gjatë ditëve të festave deri në orën 05.00.”

Paragrafi 2 bëhet paragrafi 3.

#### Neni 10

Në nenin 28 paragrafi 2 ndryshon si vijon:

“Komisionet nga paragrafi 1 i këtij neni i formon ministri i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore kompetent për punët në fushën e hotelerisë prej një përfaqësuesi nga organi i administratës shtetërore kompetent për punët në fushën e hotelerisë, përfaqësues i organit të administratës shtetërore kompetent nga fusha e shëndetësisë, përfaqësues i organit të administratës shtetërore kompetent për punët nga fusha e Punës dhe politikës sociale, përfaqësues nga vetadministrimi lokal në rajonin e të cilit bëhet kategorizimi dhe përfaqësues i ekonomisë hoteliere.”

Pas paragrafit 4 shtohet paragraf i ri 5, si vijon:

“Nëse komisionet nuk marrin aktvendim në afatin nga paragrafi 4 i këtij neni do të llogaritet se është përgjigjur pozitivisht sipas kërkesës.”

Paragrafi 5 bëhet paragrafi 6.

#### Neni 11

Në nenin 35, pika 4 ndryshon si vijon:

“4) të përmbahet në çmimet e theksuara:”

Pas pikës 4 shtohen tri pika të reja 5, 6 dhe 7 si vijojnë:

“5) të posedojnë dokumente për prodhimet furnizuara (fatura, llogari, fletëdalje dhe të ngjashme);

6) për çdo shërbim të dhënë të jepet llogari me specifikat e shërbimeve nga arka fiskale;

7) në vend të dukshëm në hyrje të objektit hotelier ta theksojë llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytëzohen;”.

Pikat 5, 6 dhe 7 bëhen pika 8, 9 dhe 10.

Pikat 8 dhe 10 shlyhen.

Pika 9 bëhet pikë 11.

Pikat 11,12 dhe 13 bëhen pika 12, 13 dhe 14 .

#### Neni 12

Në nenin 38 shtohet paragraf i ri 2, si vijon:

“Në objektet hoteliere për ushqim të shpejtë (dyqan sandviçësh) është e ndaluar shitja dhe shërbimi i pijeve alkoolike, si dhe të lëshojnë muzikë pas orës 24.00.”

#### Neni 13

Në nenin 41 paragrafi 5 shlyhet.

#### Neni 14

Në nenin 46 pikën 1 në fund të fjalisë, pikëpresja zëvendësohen me presje dhe shtohen fjalët: "me ç'rast në një objekt me çati të përbashkët mund të lëshohet vetëm një leje".

#### Neni 15

Neni 57 ndryshon si vijon:

"Mbikëqyrja inspektuese mbi zbatimin e dispozitave të këtij ligji e kryejnë Inspektorati Shtetëror i Tregut dhe organet e tjera inspektuese në pajtim me autorizimet e përcaktuara me këtë ligj ose me ligj tjetër."

#### Neni 16

Në nenin 59 paragrafin 1, pas pikës 1 shtohet pika 2 si vijon:

"2) kryen veprimtari hoteliere jashtë objektit afarist të në hapësirë të dedikuar, rregulluar dhe pajisur për ofrimin e shërbimeve hoteliere pa lejen e lëshuar nga kryetari i Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit nga kryetari i qytetit të Shkupit për shfrytëzimin e hapësirës (neni 12 paragrafi 3);".

Pikat 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9 dhe 10 bëhen pika 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

#### Neni 17

Në nenin 61 paragrafin 1 pikën 2 pas fjalës "ekonomike" vihet presje dhe shtohet fjala "juridike".

#### Neni 18

Neni 64 ndryshohet si vijon:

"Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes vërteton se hotelieri:

- 1) nuk i përmbahet çmimeve të theksuara (neni 35 paragrafi 1 pika 4);
- 2) nuk posedon dokumente për prodhimet e furnizuara (fatura, llogari, fletëdalje dhe të ngjashme) (neni 35 paragrafi 1 pika 5) dhe
- 3) për secilin shërbim të dhënë nuk lëshon llogari me specifikim të shërbimeve nga arka fiskale (neni 35 paragrafi 1 pika 6), menjëherë jep urdhër me gojë me të cilin i ndalohet kryerja e veprimtarisë hoteliere, do ta mbyllë objektin edhe atë do ta konstatoj në procesverbal.

Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori, në afat prej 3 ditëve do të marrë vendim për ndalimin e kryerjes së veprimtarisë hoteliere në kohëzgjatje prej 60 ditëve si dhe në vend të dukshëm do ta shpallë arsyen për mbylljen e objektit.

Në qoftë se hotelieri gjatë vitit kryen veprime për të cilat është shqiptuar masa nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori do të marrë vendim për ndalim të kryerjes së veprimtarisë hoteliere në kohëzgjatje prej 90 ditëve dhe do ta mbyllë objektin hotelier.

Kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund t'i parashtrahet ankesë ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore në fushën e hotelerisë.

Ankesa e paraqitur kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni, nuk e shtyn zbatimin e tij."

#### Neni 19

Neni 65 ndryshon si vijon:

"Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konstaton se hotelieri:

- 1) nuk ka dëshmi se përmbushja e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji dhe fillimi me punë i është paraqitur Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit kryetarit të Komunës në rajonin e qytetit të Shkupit sipas vendit dhe selisë së objektit, gjegjësisht sipas vendit ku jepen shërbimet, së paku 15 ditë para fillimit me punë të objektit hotelier (neni 7 paragrafi 1);

2) nuk ka dëshmi se i është paraqitur ndryshimi i kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij neni Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit kryetarit të Komunës në rajonin e qytetit të Shkupit sipas vendit dhe selisë së objektit, gjegjësisht sipas vendit ku jepen shërbimet, në afat prej 15 ditësh nga dita e ndryshimeve të krijuara (neni 7 paragrafi 2);

3) kryen veprimtari hoteliere jashtë objektit afarist në hapësirën e dedikuar, të rregulluar dhe të pajisur për dhënien e shërbimeve hoteliere pa pëlqim të lëshuar nga kryetari i Komunës, ndërsa në Qytetin e Shkupit, nga kryetari i Qytetit të Shkupit për shfrytëzimin e hapësirës (neni 12 paragrafi 3);

4) nuk i përmbahen orarit të përcaktuar të punës (neni 26 paragrafi 2);

5) në vend të dukshëm në hyrje të objektit hotelier nuk e shënon llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytëzohen (neni 35 paragrafi 1 pika 7);

6) nuk siguron hapësirë të posaçme e shënuar për duhanpirës (neni 36 paragrafi 2);

7) në objektet hoteliere ofron shërbim me pije alkoolike për persona nën moshën 18 vjeçe dhe kryen shërbimet e pijeve alkoolike nga ana e personave adoleshentë (neni 37 paragrafi 1);

8) në objektet hoteliere shërben pije alkoolike nga fillimi i kohës së punës prej orës 07,00 deri në orën 10,00 (neni 38 paragrafi 1); dhe

9) në objektet hoteliere për ushqim të shpejtë (dyqan sandviçësh) bën shitje dhe shërbim të pijeve alkoolike dhe lëshojnë muzikë pas orës 24.00 (neni 38 paragrafi 2), menjëherë jep urdhër me gojë, me të cilin i ndalohet kryerja e veprimtarisë hoteliere, do ta mbyllë objektin dhe atë do ta konstatojë në procesverbal.

Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori në afat prej 3 ditësh do të marrë vendim për ndalim të kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej 30 ditësh dhe do ta mbyllë objektin hotelier duke e theksuar në vend të dukshëm arsyen për mbylljen e tij.

Në qoftë se hotelieri në vitin rrjedhës kryen veprime për të cilat është shqiptuar masa nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori do të marrë vendim për ndalim të kryerjes së veprimtarisë hoteliere në kohëzgjatje prej 60 ditësh dhe do ta mbyllë objektin hotelier.

Kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund t'i parashtrohet ankesë ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e hotelerisë.

Ankesa e parashtruar kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni nuk e shtyn kryerjen e tij.”

## Neni 20

Neni 66 ndryshon si vijon:

“Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konstaton se:

1) veprimtaria hoteliere kryhen pa regjistrimin në regjistrin tregtar (neni 4 paragrafi 1);

2) veprimtaria hoteliere kryhet pa qenë të plotësuara kushtet e përcaktuara minimale–teknike, kushtet sanitare–higjienike dhe kushtet shëndetësore, kushtet për mbrojtje gjatë punës, mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit jetësor, mbrojtjen kundër zjarrit dhe kushtet për mbrojtje nga zhurma (neni 6 paragrafi 1 dhe 2);

3) veprimtaria hoteliere kryhet në objektet afariste ose hapësirat ku kryhet veprimtari tjetër, pa u plotësuar kushtet e përcaktuara për kryerje të veprimtarisë tjetër (neni 12 paragrafi 2);

4) veprimtaria hoteliere kryhet në objekte hoteliere, bar nate, kabare dhe disko klub pa licencë (neni 20 paragrafi 1);

5) hotelieri lejon hyrjen e personave të moshës nën 18 vjeçe (neni 35 paragrafi 1 pika 3), menjëherë jep urdhër me gojë me të cilin i ndalohet kryerja e veprimtarisë hoteliere, do ta mbyllë objektin dhe atë do ta konstatojë në procesverbal.

Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori në afat prej 3 ditësh do të marrë vendim për ndalim që kryerësi i veprimtarisë hoteliere për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej 30 ditësh me mbylljen e objekteve hoteliere duke theksuar shkakun për mbylljen e tij.

Nëse hotelieri gjatë vitit rrjedhës bën veprime për të cilat është shqiptuar masa nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori do të marrë vendim për ndalim të kryerjes së veprimtarisë në kohëzgjatje prej 60 ditësh dhe do ta mbyllë objektin hotelier.

Kundër vendimit nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni mund t'i parashtrohet ankesë ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e hotelerisë.

Ankesa e parashtruar kundër vendimit nga paragrafi 3 i këtij neni nuk e shtyn zbatimin e tij.”

#### Neni 21

Neni 67 ndryshon si vijon:

“Nëse inspektori gjatë kryerjes së mbikëqyrjes konstaton se hotelieri:

- 1) fillon me punë në objektin hotelier pa marrjen e kategorisë (neni 32 paragrafi 1) dhe
- 2) nuk ka dëshmi për ndryshimin e bërë të kategorisë së objektit hotelier në kuptim të nenit 33 paragrafin 3 të këtij ligji, menjëherë jep urdhër me gojë, me të cilin i ndalohe kryerja e veprimtarisë hoteliere, do ta mbyllë objektin dhe atë do ta konstatojë në procesverbal.

Në rastet nga paragrafi 1 i këtij neni, inspektori, në afat prej tre ditësh do të marrë vendim për ndalim të kryerjes së veprimtarisë në afat prej 15 ditësh dhe do të mbyllet objekti hotelier duke theksuar në vend të dukshëm arsyen për mbylljen e tij.

Kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i paraqitet ankesë ministrit i cili udhëheq me organin administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e hotelerisë.

Ankesa e paraqitur kundër aktvendimit nga paragrafi 2 i këtij neni nuk e shtyn zbatimin e tij.

#### Neni 22

Titulli i Kreut VIII. DISPOZITAT NDËSHKIMORE ndryshojnë si vijojnë:

“VIII. DISPOZITA PËR KUNDËRVAJTJE” dhe shtohet nen i ri 67-a, si vijon:

#### "Neni 67-a

Për kundërvajtjet të përcaktuara në nenet 69, 70, 72 dhe 73 të këtij ligji, procedurë për kundërvajtje mban dhe sanksion për kundërvajtje shqipton Inspektorati Shtetëror i Tregut (në tekstin e mëtejme: organi për kundërvajtje).

Procedura për kundërvajtje nga paragrafi 1 i këtij neni para organit për kundërvajtje e mban Komisioni për vendimmarrje për kundërvajtjet (në tekstin e mëtejme: Komision për kundërvajtje), i përbërë prej personave zyrtarë, të autorizuar nga ana e ministrit i cili udhëheq me organin e administratës shtetërore, kompetent për punët nga fusha e hotelerisë.

Inspektori Shtetëror i Tregut është i detyruar që kryerësit të kundërvajtjes t'i ofrojnë procedurë për barazim, para se të dorëzojë kërkesë për kryerje të veprimit për kundërvajtje, në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.”

#### Neni 23

Neni 68 ndryshon si vijon:

“Gjobë në vlerë prej 2.000 deri në 4.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

- 1) kryhen veprimtari hoteliere në objektet hoteliere: bar nate, kabare dhe disko klub pa licencë (neni 20 paragrafi 1);
- 2) e cedon licencën (neni 22 paragrafi 2);

- 3) nuk i përmbahet orarit të përcaktuar të punës (neni 26 paragrafi 2);
  - 4) nuk u përmbahet çmimeve të theksuara (neni 35 paragrafi 1 pika 4);
  - 5) nuk posedohen dokumente për produktet e furnizuara (faturë, llogari, fletëhyrje dhe të ngjashme (neni 35 paragrafi 1 pika 5);
  - 6) për secilin shërbim të ofruar, nuk jep llogari me specifikim të shërbimeve nga arka fiskale (neni 35 paragrafi 1 pika 6);
  - 7) nuk i jep shërbimet hoteliere të përfshira në pakon e aranzhmaneve turistike në objektin hotelier për vendosje nëpërmjet organizatorëve të udhëtimit ose ndërmjetësuesit, përkatësisht agjencive turistike (neni 35 paragrafi 1 pika 11) dhe
  - 8) shërben alkool dhe pije alkoolike për persona nën 18 vjeç (neni 37 paragrafi 1).
- Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, krahas gjobës për personin juridik do t'i shqiptohet edhe sanksioni ndalim për kryerjen e veprimtarisë hoteliere në afat prej një viti deri në tre vjet.
- Gjobë në vlerë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje edhe personit përgjegjës te personi juridik.
- Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shqiptohet gjobë në vlerë prej 800 euro në kundërvlerë të denarit në vend të ngjarjes personit juridik.
- Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, mund të shqiptohet gjobë në vlerë prej 500 euro në kundërvlerë të denarit aty për aty edhe personit përgjegjës te personi juridik.
- Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, krahas gjobës nga paragrafi 3 i këtij neni personit përgjegjës te personi juridik do t'i shqiptohet sanksion kundërvajtës ndalim për ushtrim të profesionit, të veprimtarisë ose detyrës në afat prej një viti deri në tre vjet.”

#### Neni 24

Neni 69 ndryshon si vijon:

“Gjobë në shumë prej 1.500 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik nëse:

- 1) nuk i plotëson kushtet minimale-teknike dhe kushtet e tjera të përcaktuara me ligji (neni 6 paragrafi 1);
- 2) nuk ia paraqet përmbushjen e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji dhe fillimin me punë Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit kryetarit të Komunës në rajonin e qytetit të Shkupit sipas vendit dhe selisë së objektit, gjegjësisht sipas vendit ku jepen shërbimet, së paku 15 ditë para fillimit me punë të objektit hotelier (neni 7, paragrafi 1);
- 3) nuk ia paraqet ndryshimin e kushteve nga neni 6 paragrafi 1 i këtij ligji Inspektoratit Shtetëror të Tregut, kryetarit të Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit kryetarit të Komunës në rajonin e qytetit të Shkupit sipas vendit dhe selisë së objektit, gjegjësisht sipas vendit ku jepen shërbimet në afat prej 15 ditësh nga ndryshimi i bërë (neni 7 paragrafi 2);
- 4) veprimtaria hoteliere kryhet në objektin ose hapësirën ku kryhet veprimtari tjetër pa qenë të plotësuara kushtet e përcaktuara për kryerjen e veprimtarisë hoteliere (neni 12 paragrafi 2);
- 5) veprimtaria hoteliere kryhet jashtë objektit afarist në hapësirën e dedikuar, të rregulluar dhe të pajisur për dhënien e shërbimeve hoteliere pa pëlqim të lëshuar nga kryetari i Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit nga kryetari i qytetit të Shkupit për shfrytëzimin e hapësirës (neni 12 paragrafi 3);
- 6) fillon me kryerjen e veprimtarisë para se të marrë aktvendimin për kategorinë e objektit hotelier (neni 32 paragrafi 1);
- 7) nuk i përcakton normativat për ushqime dhe pije të cilat i shërben dhe nuk u mundëson shfrytëzuesve shikim në ato normativa (neni 35 paragrafi 1 pika 7);
- 8) nuk i verifikon normativat për ushqim te kryetari i Komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit te kryetari i Komunës në rajonin e komunës të qytetit të Shkupit dhe shërbimet hoteliere nuk i jep në sasi dhe kualitetit përkatëse sipas normave të përcaktuara (neni 35 paragrafi 1 pika 8);

9) nuk mban libër të mysafirëve në objektin hotelier për vendosje (neni 35 paragrafi 1 pika 9);  
10) kryen kamping në kampe të paorganizuara (neni 42 paragrafi 2);  
11) vendoset tenda, kamp shtëpiza, kamp rimorkio dhe pajisje tjetër për kamping jashtë kampit (neni 43) dhe

12) kampingu i përkohshëm kryhet në truall i cili nuk është i përcaktuar nga Këshilli i komunës, ndërsa në qytetin e Shkupit nga Këshilli i qytetit të Shkupit (neni 44 paragrafi 2).

Për veprimet nga paragrafi 1 pika e këtij neni, krahas gjobës personit juridik do t'i shqiptohet edhe sanksion ndalim i përkohshëm për kryerjen e veprimtarisë hoteliere në kohëzgjatje prej 15 ditësh.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje personit përgjegjës te personi juridik në shumë prej 500 euro në kundërvlerë të denarit.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë të denarit aty për aty personit juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë të denarit në vendin e ngjarjes edhe personit përgjegjës te personi juridik.”

## Neni 25

Neni 70 ndryshon si vijon:

“Gjobë në shumë prej 1.000 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk ka dëshmi për ndryshimin e kryer të kategorisë për objektin hotelier (neni 33 paragrafi 3);

2) nuk i mirëmban hapësirat dhe pajisjet dhe nuk jep shërbime në objektin hotelier sipas kushteve të përcaktuara minimale–teknike, si dhe kushtet e kategorizimit për llojet e objekteve për të cilat është e paraparë kategorizimi (neni 35 paragrafi 1 pika 1);

3) në objektet nga neni 41 paragrafi 3 i këtij ligji krahas ushqimit në gjendje të konfeksionuar shërbehen edhe ushqime të tjera;

4) organizon dhe kryhet kamping në kundërshtim me nenin 42 paragrafët 1 dhe 2 të këtij ligji;

5) kampi nuk ka rend shtëpiak të vërtetuar (neni 45 paragrafi 1);

6) në hyrje të kampit ose në vend tjetër përkatës për të, nuk paraqet plan–skemën e kampit, nuk paraqet çmimet për shfrytëzimin e hapësirës për kamping, kategorinë e kampit si dhe shërbimet e tjera me të cilat i ofron kampi (neni 45 paragrafi 2);

7) nuk e thekson orarin e punës në hyrje të objektit dhe në vend të dukshëm në objekt (neni 26 paragrafi 1);

8) nuk thekson në vend të dukshëm shenjën e përcaktuar të llojit dhe kategorisë të objektit hotelier (neni 32 paragrafi 2);

9) nuk i thekson çmimet në pajtim me nenin 35 paragrafin 1 pika 2 e këtij ligji;

10) nuk thekson në vend të dukshëm në hyrje të objektit hotelier - bar nate dhe kabare, tabelë me dimensione 20x50 cm me përmbajtje: “personat me moshë nën 18 vjeçe nuk kanë të drejtë hyrjeje” (neni 35 paragrafi 1 pika 3);

11) nuk e rregullon dhe thekson rendin shtëpiak në të gjitha objektet për vendosje (neni 35 paragrafi 1 pika 10);

12) në vend të dukshëm në objektin hotelier ose në menynë nuk e shënon numrin telefonik të Inspektoratit Shtetëror të Tregut (neni 35 paragrafi 1 pika 12);

13) në të gjitha materialet propaganduese nuk i shënon llojin dhe kategorinë e objektit (neni 35 paragrafi pika 13);

14) nuk thekson në vend të dukshëm në objektin hotelier mbishkrim me përmbajtje: “personat me moshë nën 18 vjeç nuk shërbehen me pije alkoolike” (neni 37 paragrafi 2);

15) shërben pije alkoolike prej orës 07.00 deri në orën 10.00 (neni 38 paragrafi 1);

16) shet dhe shërben pije alkoolike dhe lëshon muzikë pas orës 24.00 (neni 38 paragrafi 2) dhe

17) në vend të dukshëm në hyrje të objektit hotelier nuk e thekson llojin e kartelave pagesore të cilat mund të shfrytëzohen (neni 35 paragrafi 1 pika 7).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, do t'i shqiptohet gjobë për kundërvajtje personit përgjegjës te personi juridik në shumë prej 400 euro në kundërvlerë të denarit.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet gjobë në vlerë prej 400 euro në kundërvlerë të denarit në vendin e ngjarjes edhe personit juridik.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet gjobë në vlerë prej 300 euro në kundërvlerë të denarit në vendin e ngjarjes edhe personit përgjegjës.”

#### Neni 26

Neni 71 fshihet.

#### Neni 27

Neni 72 ndryshon si vijon:

“Gjobë në shumë prej 700 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje tregtarit–individ për veprimet nga nenet 69, 70 dhe 71 të këtij ligji.

Krahas gjobës nga paragrafi 1 i këtij neni do t'i shqiptohet edhe sanksion kundërvajtës ndalim për kryerjen e veprimtarisë në kohëzgjatje prej së paku tri ditë deri më së shumti 30 ditë.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë të denarit në vendin e ngjarjes tregtarit–individ.”

#### Neni 28

Neni 73 ndryshon si vijon:

“Gjobë në shumë prej 400 euro në kundërvlerë të denarit do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik nëse:

1) merr me qira dhoma, apartamente, shtëpi pushimi në kundërshtim me nenin 46 paragrafin 1 pikën 1 të këtij ligji;

2) organizon kamp dhe jep shërbime në kundërshtim me nenin 46 paragrafin 1 pikën 2 të këtij ligji;

3) jep shërbime të ngrënies mëngjes në kundërshtim me nenin 46 paragrafin 1 pikën 3;

4) i jep me qira dhomat, apartamentet, shtëpitë dhe banesat për pushim pa marrëveshje të lidhur me agjenci turistike, byro turistike dhe shoqëri tregtare të regjistruara për kryerjen e veprimtarisë hoteliere (neni 48);

5) në vend të dukshëm nuk e thekson llojin dhe kategorinë e objektit (neni 51 paragrafi 1 pika 1);

6) anëtarë i familjes ose personat që u ndihmojnë anëtarëve të familjes nuk i plotësojnë kushtet shëndetësore për punë në hoteleri në kuptim të nenit 52 paragrafit 2 të këtij ligji;

7) jep shërbime në vend ankorimi dhe porte, si dhe kur objekti i lundrimit rrotullohet jashtë vendit të ankorimit dhe portit personave të cilët nuk gjenden në objektin lundruar për shkak të transportit (neni 54 paragrafi 4);

8) shtëpitë, apartamentet dhe dhomat nuk i plotësojnë kushtet teknike–minimale dhe kushtet për kategorizim në kuptim të nenit 6 të këtij ligji (neni 47 paragrafi 1);

9) në vend të dukshëm nuk i thekson emërtimet e shërbimeve të cilat i ofron nga neni 51 paragrafi 1 pika 2 e këtij ligji;

10) nuk mban libër evidence të mysafirëve (neni 51 paragrafi 1 pika 5);

11) në vend të dukshëm në objekt nuk e shënon numrin telefonik të Inspektoratit Shtetëror të Tregut (neni 51 paragrafi 1 pika 6) dhe

12) jep shërbime në objekte lundruese për më shumë se 20 mysafirë njëkohësisht (neni 54 paragrafi 3).

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni, krahas gjobës nga paragrafi 1 i këtij neni personit fizik do t'i shqiptohet edhe sanksion ndalim i për kryerjen e veprimtarisëhoteliere në kohëzgjatje prej 15 ditësh.

Për veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni mund t'i shqiptohet gjobë në shumë prej 300 euro në kundërvlerë të denarit aty për aty personit fizik.

#### Neni 29

Nenet 74 dhe 75 fshihen.

#### Neni 30

Obligohet Komisioni juridiko-ligjdhënës pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të vërtetojë tekstin e spastruar të Ligjit për veprimtari hoteliere.

#### Neni 31

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e shpalljes në “Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë.”